

BULETIN BINJAKËZIMI

Buletin tremujor i publikuar nga Projekti i Binjakëzimit 'Mbështetje për Statistikat' në Kosovë - projekt i financuar nga programi i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian për shtetet IPA

Rritja e përputhshmërisë me standardet e BE-së në fushën e statistikës

> Ky është buletini i tretë i Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE-ja, "Mbështetje për Statistikat" Kosovë (KS 12 IB ST 01).

Ky projekt i financuar nga BE-ja implementohet nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim me Statistikat e Danimarkës. Gjithashtu, janë të përfshirë ekspertë nga Finlanda, Lituanja, Irlanda Veriore dhe Italia.

Tashmë ka përfunduar muaji i nëntë i implementimit të projektit. Çdo buletin i përgatitur në baza tremujore paraqet një vështrim të përgjithshëm mbi aktivitetet e realizuara gjatë atij tremujori, në këtë rast Qershor, Korrik dhe Gusht.

> Projekti mbulon katër komponente:

Komponenti 1. Një sistem cilësie për statistikën. Ky komponent ka për qëllim të fuqizojë kapacitetin e përgjithshëm të ASK-së.

Komponenti 2. Llogaritë Kombëtare. Qëllimi do të jetë rritja e përputhshmërisë me standardet aktuale të BE-së, me fokus të veçantë në fillimin e prodhimit të Llogarive Kombëtare në baza tremujore.

Komponenti 3. Statistikat e Biznesit. Projekti, mes të tjerash, do të punojë me ASK-në në përmirësimin e Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve, prodhimin e indikatorëve afatshkurtër dhe përmirësimin e Regjistrat Statistikor të Bizneseve.

Komponenti 4. TI dhe Diseminimi. Aktivitetet në komponentin 4 janë dizajnuar për të përmirësuar sistemet e TI-së në ASK dhe cilësinë e diseminimit të statistikave nga ASK-ja.

> Takimi me përdoruesit e statistikave

Në kuadër të komponentit 1, Një sistem cilësie për Statistikat, ASK-ja, me mbështetjen e ekspertëve nga vendet anëtare, ka organizuar një takim me përdoruesit e statistikave. Ky takim, i pari në



■ Z. Isa Krasniqi, Z. Lars Thygesen, Znj. Hilkka Vihavainen

kuadër të projektit, u mbajt më 22 tetor 2014. Takimin e hapi Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së, z. Isa Krasniqi. Lars Thygesen, Drejtor nga Statistikat e Danimarkës, foli për çështjet fundamentale të rëndësisë së statistikave dhe në veçanti të cilësisë statistikore. Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit të TI dhe Metodologjisë, foli për Politikën Statistikore të ASK-së dhe progresin e arritur gjatë Projektit të Binjakëzimit, si formimi i Komitetit për Cilësi, që tani është funksional, dhe emërimi i Menaxherit për Cilësi në ASK. Znj. Annegrete Wulff, Shefe e Divizionit në Statistikat e Danimarkës, demonstroi mundësitë e databazës statistikore, që do të jetë në dispozicion në faqen e ASK sa më shpejt që është e mundur, falas, për të gjithë përdoruesit e jashtëm. Znj. Hilkka Vihavainen, ish Drejtoreshë e Statistikave të Finlandës, udhëhoqi sesionin "Pyetje për përdoruesit" dhe pati një diskutim aktiv dhe interesant për mundësinë e pasjes së të gjitha të dhënave në databazën statistikore në ASK. Pjesëmarrësit gjithashtu plotësuan një pyetësor mbi kënaqshmërinë e përdoruesve, rezultatet e të cilit janë shumë të vlefshme për ASK-në.

> 8 misione gjatë tremujorit të kaluar

Deri tani janë realizuar gjithsej 21 misione, 8 nga të cilët gjatë tremujorit të kaluar. Projekti po përparon mirë dhe ka pasur misione në katër komponentet.

Sa i përket punës rreth cilësisë në ASK, Projekti i Binjakëzimit ka mbështetur dy anëtarë të Komitetit të sapoformuar për Cilësi të marrin pjesë në Konferencën për Cilësi, të mbajtur në Vjenë, në qershor të vitit 2014. ASK-ja dhe ekspertët e vendeve anëtare kanë vazhduar të punojnë në fusha si: Sistemi i Cilësisë, Llogaritë Kombëtare Tremujore, Statistikat Strukturore të Biznesit, Indikatorët e Prodhimit Industrial, Statistikat Afatshkurta, Regjistrat Statistikor të Bizneseve dhe Dizajnimin e Udhëzuesve për Publikim Elektronik dhe të Shtypur. Gjatë 9 muajve të fundit në projekt kanë qenë të përfshirë ekspertë nga Danimarka, Finlanda, Italia dhe Lituanja.

Tremujori i tretë i projektit ka qenë mjaft intensiv dhe të gjithë ekspertët nga vendet anëtare dhe profesionistët në ASK kanë punuar shumë. 27 aktivitete të tjera janë planifikuar për dy tremujorët e ardhshëm – përsëri, në katër komponentet.

Per Knudsen Resident Twinning Adviser (RTA)

EU Twinning Project
Support to Statistics in Kosovo
Tel. (RKS) +386 (0)49819307
Tel. (DK) +45 28357071

Project information is available from,
the website

WWW.DST.DK/KOSOVO



This project is funded by the European Union



This project is implemented by Statistics Denmark